



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian

Raport vendimmarrjeje

Nr 2 /Datë 25.03 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin “PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2025-2030 PËR BASHKINË POGRADEÇ”, shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 27.03.2025

Analiza ligjore:

Ky projekt -vendim është hartuar në mbështetje të nenit 113, pika 2, të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 36 dhe 37 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit 16/2018 “Për Diasporën”, i ndryshuar, Ligjit 113/2020 “Për shtetësinë” i ndryshuar, Ligjit nr. 79/2021 “Për të Huajt”, Ligjit nr.7939, datë 25.5.1995 “Për Migracionin”, i ndryshuar, VKM nr. 152, datë 13.3.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”, VKB nr. 152, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit të Mbrojtjes Sociale 2024-2027 për Bashkinë Pogradec”.

Situata aktuale e funksionit:

Drejtoria e Shërbimit Social, me asistencën e GIZ Albania ka përgatitur Planin e Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën për vitet 2025-2030 për Bashkinë Pogradec.

Migracioni dhe diaspora kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në Bashkinë e Pogradecit. Ky plan synon të integrojë këto aspekte në politikat dhe strategjitë vendore duke ofruar një platformë bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm midis komunitetit lokal dhe diasporës së Pogradecit.

Ky plan synon, gjithashtu, riintegrimin e emigrantëve që kthehen, nxitjen e investimeve të diasporës dhe krijimin e mekanizmave për përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe zhvillimin e projekteve lokale.

Proçesi i hartimit të planit është bazuar në Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2024-2030, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2021-2025, Strategjia Kombëtare e Punësimit 2023-2030, Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen vendore 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

Situata financiare:

Sipas detajimit të buxhetit të planit.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Qytetaret e bashkisë Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Po, është kryer konsultimi publik dhe janë reflektuar tek dokumenti mendimet e qytetareve.

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, I mbledhur më datë 25.03 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për “PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2025-2030 PËR BASHKINË POGRADEK” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T’i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
 - b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
 - c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
 - d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)
-
-

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Mumozë Shuli  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Arben Male  **Sekretar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 25.03.2025 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve, Rekreacionit, Parkingjeve, Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit

Raport vendimarrjeje

Nr 5 /Datë 25.03, 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin PER “DETAJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE KUSHTEZUAR PER MBROJTJEN CIVILE 2025” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 27.03.2025

Analiza ligjore:

Projekt vendimi është bazuar ligjit 45/ 2019, “Për mbrojtjen civile”, përkatësisht kreu II, neni 8, shkronja ç, kreu II, neni 23, shkronja d dhe nenit 15 të ligjit 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ligjit nr. 139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”; VKM 414 dt 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, shkresës nr. 2126/1 prot., datë 19.02.2025 “Dërgohen buxhetet e bashkive për vitin 2025

Situata aktuale e funksionit:

Projekt Vendimi që po paraqitet për miratim ka të bëjë me detajimin e fondeve për emergjencat civile. Në bazë të pikes c te VKM 414 dt 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, është bërë detajimi i fondeve duke respektuar kriteret e vendosura në VKM. Duke u bazuar dhe tek nevojat e Bashkisë dhe Drejtorisë së Emergjencave janë sjelle për miratim në KB të gjitha zërat të detajuara në Relacionin e këtij projekt vendimi.

Situata financiare:

Shuma e planifikuar është 13,318,317 leke, e detajuar sipas tabelës në Relacionin e këtij projekt vendimi.

Drejtoria/Spektori përgjegjës:

Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, pranë Bashkisë Pogradec.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetaret e bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Jo

Komisioni I perhershëm i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve, Rekreacionit, Parkingjeve, Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimiti, mbledhur më datë 25.03 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për "DETAJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE KUSHTEZUAR PER MBROJTJEN CIVILE 2025" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Ahmed Guxholli Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Yollca Pllaha Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Data 25.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit, Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqyrjes Financiare, Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural

Raport vendimmarrjeje

Nr 3 /Datë 25.03 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin “Miratimi i Tavanëve Buxhetore për vitet 2026-2028” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 27.03.2025.

Analiza ligjore:

Ligji nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, neni 9, pika 1.3, shkronja “c”; neneve 34, 40, 41, neni 54 shkronja “dh”; Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” I ndryshuar; Ligji nr 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë” I ndryshuar, Ligjin nr 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar; Ligji nr 115 dt 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, VKB nr 141 date 27.12.2024 “Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025”, Udhezimin nr 23 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të Njesive të qeverisjes vendore”. Udhezim nr 8 date 28.02.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028;

Situata aktuale e funksionit:

Ne bazë të Udhezimit nr 8 date 28.02.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028, burimet e financimit për PBA 2026-2028 perbehen nga Te ardhurat e veta, Transferta e pakushtezuar, Transferta e kushtezuar. Bazuar në të dhënat financiare të paraqitura në relacionin përkatës dhe në tabelat që e shoqërojnë ato, është bërë edhe planifikimi për tavanet përgatitore buxhetore për 2026-2028.

Situata financiare:

Situata financiare dhe të dhëna me të detajuara është paraqitur në relacionin dhe tabelat shoqëruese të tij

Drejtoria/Spektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Finances dhe Buxhetit

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetaret e bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Eshte marre mendimi I qytetareve per tavanet pergatitore permes nje sondazhi on line


Komisioni i përhershëm i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit, Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqyrjes Financiare, Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, i mbledhur më datë 25.03 2025, shqyrtoi projektvendimin “Miratimi i Tavanëve Buxhetore për vitet 2026-2028” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T’i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Gehrik Hashellari  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Mimoza Shuli  **Sekretar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 27.03. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit, Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqyrjes Financiare, Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural

Raport vendimarrjeje

Nr 1 /Datë 25.03 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 13, DATË 27.01.2025 "MIRATIMIN E VLERËSIMEVE DHE PARASHIKIMIT AFATMESËM TË TË ARDHURAVE NË BASHKINË POGRADEÇ, PËR VITET 2026-2028" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 27.03.2025

Analiza ligjore:

Projekt – vendimi u hartua në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, i ndryshuar, VKM nr.132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.8. datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Situata aktuale e funksionit:

Ekzekutivi prezanton kete projekt-vendim qe të miratojë ndryshimet në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.13, datë 27.01.2025 "Miratimin e vlerësimeve dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave në Bashkisë Pogradec, për vitet 2026-2028", referuar Tabeles "Ecuria e të ardhurave dhe parashikimi për tre vitet e tjera buxhetore", pjese e Relacionit te ketij projekt-vendimi.

Situata financiare:

Situata financiare dhe te dhena me te detajuara eshte paraqitur ne relacionin dhe tabelat shoqeruese te tij

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Finances dhe Buxhetit

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Finances dhe Buxhetit

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetaret e bashkise Pogradec

Komisioni i përhershëm i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit, Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqyrjes Financiare, Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, i mbledhur më datë 25.03 2025, shqyrtoi projektvendimin DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 13, DATË 27.01.2025 "MIRATIMIN E VLERËSIMEVE DHE PARASHIKIMIT AFATMESËM TË TË ARDHURAVE NË BASHKINË POGRADEK, PËR VITET 2026-2028", shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Gelmek Hashullari Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Memoza Shuli Sekretar i komisionit

Data 25.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

**Komisioni i Arsimit, Sporteve Aktiviteteve Çlodhëse, Kulturës, Trashëgimisë Kulturore,
Dhënies së Titujve dhe Emërtimeve**

Raport vendimmarrjeje

Nr 4 /Datë 25.03 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin “TRAJTIMIN ME BURSE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 27.03.2025

Analiza ligjore:

Projekt-vendimi prezantohet në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 2, të Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 5, ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit të kontrollit të brendshëm, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, të forcave të armatosura, të shërbimit informativ shtetëror dhe të policisë së burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666 datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, shkresës me nr. 7228/42, datë: 18.11.2024 me lëndë “Dërgohet plani i bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025.”, me propozim të kryetarit të Bashkisë.

Situata aktuale e funksionit:

Referuar me sipër, në bashkinë Pogradec është dërguar plani i bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin

shkollor 2024-2025. Janë akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit 40 (dyzetë) bursa për shkollat e arsimit parauniversitar.

Përsa i përket shkollave 9-vjeçare të qytetit dhe njësive administrative janë 35 nxënës të cilët plotësojnë kriterin jo ekonomik fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit dhe 4 nxënës që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë.

Është 1 nxënës i cili plotëson pikën a) të kriterit ekonomik. Ky nxënës studion në shkollën e mesme artistike “Tefta Tashko Koço” në qytetin e Korçës.

Situata financiare:

Shpenzimet do të mbeshketen në bazën ligjore referuar tek ky projekt-vendim.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Qendra Arsimore, Bashkia Pogradec, dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar
Monitorimi dhe raportimi:

Qendra Arsimore, Bashkia Pogradec, dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar
Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Nxënës të arsimit parauniversitar të bashkisë Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Jo

Komisioni i Arsimit, Sporteve Aktiviteteve Çlodhëse, Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve dhe Emërtimeve, i mbledhur më datë 25.03 2025, shqyrtoi projektvendimin për “TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T’i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
 - b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Keshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
 - c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
 - d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)
-
-

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Liri Seifllari Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Besnik Xhysa Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 25.03.2025 2025

Besnik Xhysa